



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	12.04.2019
REFERENC-Ë:	17/3526/535/DMMU
PËR/ZA/TO:	“Te Bekimi” L.L.C. Kamaran- Gllgoc Qendër grumbulluese dhe çmontuese e automjeteve mbeturin dhe komponentët e tyre në Sankoc- Gllgoc
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë “Te Bekimi” L.L.C. Kamaran- Gllgoc, me nr. prot. 17/3526/535/DMMU, të datës: 14.07.2017.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë “Te Bekimi” L.L.C. Kamaran- Gllgoc, për veprimtarinë: qendër grumbulluese dhe çmontuese e automjeteve mbeturin dhe komponentët e tyre në Sankoc - Gllgoc.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Leje Mjedisore

Kompanisë “Te Bekimi” L.L.C. Kamaran- Gllgoc, për veprimtarinë: qendër grumbulluese dhe çmontuese e automjeteve mbeturin dhe komponentët e tyre në Sankoc - Gllgoc.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe shqyrtimit të informatave shtesë për kompaninë “Te Bekimi” L.L.C. Kamaran- Gllgoc, për veprimtarinë: qendër grumbulluese dhe çmontuese e automjeteve mbeturin dhe komponentët e tyre, në ngastrën kadastrale nr. 26-0, zona kadastrale Sankoc - Gllgoc, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për leshuarjen e Lejes Mjedisore.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Pjesët e çmontuara nga automjete (pjesët që përmbajnë vajra), fuqitë (buret) të vajrave mbeturinë, filtrat e vajrave, bateritë, akumulatorët mbeturinë, të mbahen në vend të betonuar, mbuluar dhe izoluar.

Faqe 2 nga 3



- Vajrat mbeturinë të dërgohen të kompania e licencuar për grumbullimin e vajrave, dhe të mbajë regjistër për llojin dhe sasinë;
- Mbeturinat të klasifikohen sipas llojit të tyre, të vendosen në vende ose kontejner të posaçëm, ku secili prej tyre ta këtë mbishkrimin për llojin e mbeturinës;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të ketë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPH;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2. të Ligjit për Mbrojtje e Mjedisit Nr. 03/L-25 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 17/3526/ZSP/199/19 datë: 12.04.2019.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabineti të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së



Faqe 3 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Department of Environment Protection and Water / Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu

DATË/A:	12.04.2019
REFERENC-Ë:	17/3526/535/DMMU
PËR/ZA/TO:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Flet përcjellëse për lëshuarjen e Lejes Mjedisore

Bazuar në kërkesën e bërë nga kompania "Te Bekimi" L.L.C. Kamaran- Glllogoc, me nr. prot. 17/3526/535/DMMU, për tu pajisur me Leje Mjedisore për veprimtarinë: qendër grumbulluese dhe çmontuese e automjeteve mbeturin dhe komponentëve të tyre në Sankoc- Glllogoc, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1